



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:141204
Datë: 31.05.2024
Numri i dokumentit: 05766681

C.nr.2294/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari Taulant Rexhëbeqaj, me bashkëpunëtorin profesional L.K. në çështje juridike kontestimore të paditëses D.K. nga Prizreni, përfaqësuar nga av. B.K. nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, me objekt kontesti: kompensimin e qerasë për shkak të shfrytëzimit të pa bazë, vlera e kontestit 100,000.00 euro gjatë shqyrtimit paraprak të padisë, jashtë seancës gjyqësore me datën 31.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET poshtë si e palejuar, padia e paditëses D.K. nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, për shkak të kompensimit të qerasë për shkak të shfrytëzimit të pa bazë, pasi padia është paraqitur nga personi i pa autorizuar si veprim i parë i ndërmarrë procedural.

A r s y e t i m

Paditësja D.K. nga Prizreni, ka paraqitur padi kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, me objekt kontesti: kompensimin e qerasë për shkak të shfrytëzimit të pa bazë, vlera e caktuar e kontestit 100,000.00 euro.

Padisë së iniciuar nuk i është paguar taksa gjyqësore dhe nuk i është bashkangjitur autorizimi i përfaqësuesit të paditëses, për këtë arsye, gjykata në Aktvendimin e datës 08.04.2024, në kuptim të dispozitës së nenit 253.4 dhe 93.2 të LPK-së, e fton paditësen që të paguaj taksën gjyqësore në shumë prej 150 euro sipas vlerës së caktuar të kontestit prej 100,000.00 euro dhe që t'ia dorëzoj gjykatës parashtrësën e kërkuar - autorizimin në afat prej 3 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktvendimi, në pikën IV të këtij aktvendimi është njoftuar për pasojat në rast të mos veprimi sipas këtij aktvendimi.

Gjykata nuk ka mundësi të veprojë sipas padisë së paditëses për shkak se paditësja brenda afatit të caktuar nga gjykata nuk ka paguar taksën gjyqësore dhe nuk ka paraqitur autorizim për av. Bestar Kolgeci nga Prizreni, e në mbështetje të nenit 93 par.3 të LPK-së, ku thuhet se “ ...Në qoftë se ky afat kalon pa sukses, gjykata do t'i anulojë veprimet procedurale të kryera nga

personi pa prokurë...” dhe nenit 390 të LPK-së, parashihet që: “Nëse gjykata konstaton se padia është e pakuptueshme apo jo e plotë, apo se ekzistojnë mungesa që kanë të bëjnë me zotësinë e paditësit apo të paditurit që të bëhet palë ndërgjyqëse, apo me përfaqësimin ligjor të tyre, apo mungesa që i përkasin autorizimit të përfaqësuesit që ta inicioj procedurën kontestimore, kur autorizimi i tillë kërkohet me ligj, gjykata me qëllim të heqjes së mungesave të tilla i ndërmerr masat e nevojshme të përcaktuara me këtë ligj (neni 79 dhe 102 i këtij ligji)”.

Gjykata konstaton se padia e paraqitur nga av. B.K. nga Prizreni, është inicuar nga personi i pa autorizuar dhe i njëjti në afatin e caktuar nga gjykata nuk e ka prezantuar autorizimin e palës paditëse, ndërsa që në shkresat e kësaj lënde nuk ekzistojnë provat që i njëjti të ketë vepruar konform këtij vendimi. Mbi këto rrethana gjykata gjeti se janë plotësuar kushtet për të vepruar në kuptim të nenit 93.3 të LPK-së, për të anuluar të gjitha veprimet e ndërmarra në këtë procedurë dhe rrjedhimisht për të hedhur poshtë padinë si veprim i parë i ndërmarrë procedural.

Në bazë lartcekurave në kuptim të nenit 102.3 lidhur me neni 93.3, 253.5 dhe 390 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
C.nr.2294/2022, datë 31.05.2024

Gjyqtari

Taulant Rexhëbeqaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.